



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA

# **Raporti i aktivitetit për Vitin 2020**

## Tabela e Përmbajtjes

1. Baza ligjore, ndryshimet e reflektuara në ligjin 10192/2009 dhe 34/2019. Puna për permiresimet ligjore në funksion të regjimit të sekuestrimit, konfiskimit dhe funksionimit të AAPSK-së.
2. Proceset gjyqësore dhe vendimet e gjykatave për vitin 2020.
3. Mbi takimet e Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar,
4. Informacion mbi pasuritë e sekuestruara, konfiskuara dhe revokuara për vitin 2020 nën administrimin e A.A.P.S.K-së:
  - Në total
  - Me Aktin Normativ nr.1,dt 31.01.2020(OFL).
  - Me ligjin 10192/209 i ndryshuar dhe KPP
5. Efektiviteti i përdorimit të pasurive të paluajtshme të dhëna me qira dhe investimin e llogarive bankare.
6. Të ardhurat dhe shpenzimet.
7. Mbi realizimin e prokurimeve për vitin 2020.
8. Funksionimi administrativ i AAPSK.
9. Disa elemente të performancës së AAPSK-së. Administrimi i drejtperdrejte i disa shoqërive të sekuestruara.
10. Problemet me të cilat jemi ndeshur dhe kërkojnë zgjidhje në të ardhmen e afërt, në përputhje me riformatimin e AAPSK dhe shtimit të volumit të punës dhe aktivitetit të saj.

*Agjencia ka për objekt të veprimitarisë:*

- 1- Administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara me vendim të gjykatës, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin 70, dt. 27.4.2017 dhe ligjit te ri nr.34, dt 4.07.2019”Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar.*
- 2- Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara, në zbatim të ligjit nr. Nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit.”*
- 3- Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara sipas Aktit Normativ( OFL), nr.1 dt 31.01.2020 “ Për masat parandaluese ne kuadër te forcimit te luftës kundër terrorizmit , krimit te organizuar, krimeve te renda dhe konsolidimit te rendit e sigurisë publike”*
- 4- Administrimin e pasurive të tjera të sekuestruara e të konfiskuara, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to, administrimi i të cilave i caktohet kësaj Agjencie me ligj, me vendim gjykate apo urdhër të Ministrit.*
- 5- Administrimi i provave materiale të konfiskuara dhe shitja e tyre me vendim Komiteti.*

1- Baza ligjore, ndryshimet e reflektuara në ligjin 1092/2009 dhe 34/2019, implementimi i Aktit Normativ nr.1,dt 31.01.2020. Puna për përmiresimet ligjore në funksion të regjimit të sekuestrimit, konfiskimit dhe funksionimit të AAPSK-së.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është ngritur në zbatim të normave të parashikuara në ligjin nr. 9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Në vitin 2009, u miratua **ligji nr. 10192, dt. 3.12.2009** “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin **70/2017, dt. 27.4.2017**, i ndryshuar.

Në ndryshimet me themelore që çuan në përmirësimin e ligjit 10192/2009, mund të përmendim:

1. Dorëzimi i pasurive do të realizohet në përputhje të plotë me Kodin e Procedurës Penale nga ana e prokurorit dhe ekzekutimi i vendimit të sekuestrimit apo konfiskimit, nga ana e Oficerit të Policisë Gjyqësore pranë tij. Kjo shmang vonesat e një hallkë problematike si ajo e përmbaruesit, evidenton me mire dhe sakte pasurinë dhe njeh organin e akuzës me gjendjen e saj në momentin e marrjes në administrim.
2. Heq detyrimet e mëparshme që mund të ketë pasur pasuria, për të mos e ngarkuar atë me këto detyrime.

Në muajin korik të vitit 2019 doli ligji me **nr. 34, date 4.07.2019** “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”. Në kuadër të ndryshimeve të ndodhura në sistemin e ruajtjes dhe sigurisë publike, në sistemin e drejtësisë, daljes së OFL në përputhje me ligjin 18/2020 dhe

rritjes së punës në luftën kundër krimit të organizuar, me anë të ligjit nr.19, datë 5.03.2020 “për disa ndryshime ne ligjin 34/2029 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, u miratuan ndryshime themelore në ligjin 34/2019, të cilat konsistojnë në sa më poshtë vijon:

- AAPSK kalon në varësi të Ministrisë së Rendit dhe Sigurisë Publike.
- Rritet roli vendimtarës i Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar.
- Administrator i pasurive i caktuar nga gjykata është agjencia, e cila emëron administratorin e pasurisë.
- Agjencia është institucioni qëndror që administron provat materiale.

***Në zbatim të kërkesave të reflektuara në ndryshimet e ligjit 34/2019 prej ligjit 19/2020, janë miratuar :***

1. VKM me nr. 888, dt 11.11.2020 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara
2. VKM me nr.825,dt.28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”.
3. Urdhri i Kryeministrit nr. 14, dt 13.01.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AAPSK”
4. Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm me nr. 374,dt 18.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posacëm për parandalimin e kriminalitetit”.
5. Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr.324,dt, 02.10.2020 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave për administrimin e të ardhurave dhe limitet e kryerjes së shpenzimeve për pasuritë e sekuestrura dhe konfiskuara”
6. Urdhri i Ministrit të Brendshëm nr.323,dt, 02.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave për hartimit e listës të administratorëve të pasurive të sekuestruara, pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”
7. Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr.80,dt, 06.03.2020 “Për kushtet e zbatimit të urdhrin për evakuimin e ndërtesave që janë objekt i masës së sekuestros”

dhe është drejt miratimit në KM, projekt vendimi “Për kufijtë pagave apo shpërblimit të personelit të jashtëm të kontraktuar nga AAPSK-ja”.

Me miratimin e projekt VKM-ve dhe akteve të tjera normative në zbatim te ligjit nr. 34, date 4.07.2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, VKM-të me nr.687 dhe 632, si dhe udhëzimet e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, shfuqizohen.

Është miratuar Kodi i Etikës i Agjencisë( i riformuluar) me nr.prot.242 datë 27.02.2018, në të cilin përcaktohen rregullat e etikës që duhet t’u përmbahen të gjithë punonjësit e AAPSK dhe është në

purfundim projekt rregullorja e funksionimit të AAPSK në përputhje me strukturën dhe organikën e re.

Me formatimin e plotë të strukturës dhe miratimin e këtyre akteve nënligjore, rritet ndjeshëm efikasiteti i punës së AAPSK.

## 2-Proceset gjyqësore dhe vendimet e gjykatave për vitin 2020.

Gjatë vitit 2020 në AAPSK kanë mbritur 191 vendime gjyqësore dhe konkretisht:

1. **163** vendime gjyqësore sipas Aktit Normativ nr.1 dt 31.01.2020 “ Për masat parandaluese ne kuadër te forcimit te luftës kundër terrorizmit , krimit te organizuar, krimeve te renda dhe konsolidimit te rendit e sigurisë publike”,
2. **15** vendime gjyqësore janë sipas ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar.
3. **13** vendime gjyqësore janë sipas Kodit të Proçedurës Penale.

Inventari i plotë i vendimeve gjyqësore paraqitet në tabelën 8, në anekset bashkalidhur këtij raporti.

## 3- Mbi takimet e Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit te Organizuar, urdhrat e Ministrit te Financave dhe informacion mbi ndjekjen e tematikave që kanë dalë gjatë kësaj periudhe.

Me urdherin e Ministrit të Fiancave dhe Ekonomise me nr.178, dt 14.05.2019 “Mbi menyren e perdorimit te pasurive Vlera Monetare te konfiskuara” Fondi i krijuar nga konfiskimi prej 229,265,876.0 lekë u nda në :

- A. 70 milion lekë te derdhen në buxhet.
- B. 61.4 milion lekë për AAPSK-në.
- C. *Pjesa tjeter prej rreth 97.8 milion leke te mbetet si fond i veçante në përputhje me projektet e propozuar nga institucionet.*

Deri tani janë derdhur fondet për AAPSK-në 61.4 milion lekë dhe 70 milion lekë në buxhet.

Me formatimin e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit te Organizuar në fund të shtatorit të 2020, në përputhje me ndryshimet e ndodhura ligjore, me dt 20.10.2020, eshte mbajtur takimi i pare i komitetit ku me vendim nr 1. Dt 20.10.2020 u miratua “Rregullorja e Brendshme e Komitetit” (Mbi menyren e funksionimit te KNMKKO) dhe me dt 20.11.2020 u mbajt mbledhja e dyte e komitetit ku me vendim nr 2. Dt 20.11.2020 u vendos “Mbi menyren e perdorimit te pasurive vlera monetare te konfiskuara” ne vleren 93,403,412.42 leke si me poshte:

*-80% e shumes te perdoret per financimin e projekteve per Institucionet Ligjzbatuese sic eshte Policia dhe Prokuroria.*

*-20% e shumes per financimin e projekteve te shoqerise civile mbi perdorimin social.*

Eshte realizuar thirrja gjate muajit dhjetor ne faqen e MB dhe te AAPSK per OJF per te aplikuar projekte sociale me fondet e konfiskimit si dhe u eshte kerkuar institucioneve ligjzbatuese te sjellin projektet e tyre qe te financohen me qellim rritjen e kapaciteteve dhe permiresimin e hetimit ne zbatim te ligjit 10192.

Ne mbledhjen e ardhshme te komitetit do trajtohet financimi i ketyre projekteve.

4- Informacion mbi pasuritë e sekuestruara, konfiskuara dhe revokuara për vitin 2020, nën administrimin e A.A.P.S.K-së.

**4.1 Pasuri të sekuestruara sipas ligjit kundër financimit të terrorizmit** Nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”. Për vitin 2019 nuk ka pasuri te sekuestruara apo konfiskuara, në bazë të ligjit kundër financimit të terrorizmit Nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

**4.2 Pasuritë në administrim sipas llojit dhe statusit të tyre.**

Pasuritë në administrim sipas llojit dhe statusit të tyre në fund të vitit 2019 paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Nr.rend.	Pasurite sipas statusit	Numri i pasurive	Vlera në lekë
1	Pasuri të sekuestruara	182	<b>3,126,433,470.85</b>
2	Pasuri të konfiskuara	59	<b>472,052,182.0</b>
Llogari bankare të revokuara pa dorëzuara			
Nr	22	Vlera në lekë	10,368,379.39

**4.3.1 Pasuritë e marra në administrim gjatë vitit 2020.**

Gjate kësaj periudhe janë konfiskuar 5 pasuri dhe janë sekuestruar 230 pasuri, një shifër kjo e lartë për faktin e implementimit të Aktit Normativ nr.1 dt 31.01.2020 “ Për masat parandaluese ne kuadër te forcimit te luftës kundër terrorizmit , krimin të organizuar, krimeve e renda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”.

Në pasqyrat e mëposhtme jepen pasuritë e mara në administrim për vitin 2020, sipas llojit, statusit dhe aktit, konkretisht:

1. Pasuritë e marra në administrim sipas aktit normativ nr.1,dt 31.01.2020 “ Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit , krimit të organizuar, krimeve të renda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike” (OFL) në vitit 2020. Pasqyra 1.
2. Pasurite e mara në administrim me ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar. Pasqyra 2.
3. Të gjitha pasurite e mara në administrim për vitin 2020. Pasqyra 3.
4. Pasuritë e revokuar në 2020. Pasqyra 4.

Në pasqyrën e mëposhtme jepen pasuritë e mara në administrim me OFL sipas llojit dhe konkretisht :

pasqyra 1

**Pasurite e mara nga OFL per 2020**

nr.rend	Emertimi	Te vleresara	Vlera e perafert	Pasuri te konfiskuara		Ne proces vleresimi dhe sakesimi	Totali I pasurive dhe vlera	
				Nr.	Vlera e perafert		Nr	Vlera e perafert, në leke
1	Automjete	62	72,501,770.00	<b>Nuk ka</b>			62	72,501,770.00
2	apartamente	14	52,796,550.00		1	15	52,796,550.00	
3	Njesi tregëtare	12	75,534,401.00		7	19	75,534,401.00	
4	Ndertesa	12	226870733		1	13	226870733	
5	Troje, troje&ndertesa,toka	30	259946746.4		1	31	259946746.4	
6	Biznese	8	271812880		2	10	271812880	
7	Llogari Bankare	3	30133.79			3	30133.79	
	<b>Totali</b>	141	959,493,214.19		<b>12</b>	<b>153</b>	<b>959,493,214.19</b>	

Sikundër shihet edhe nga pasqyra 1 numrin më të madh të pasurive të sekuestruara e zene :

- 62 automjetet me nje vlerë të përafërt prej **72,501,770.00** lekë,
- 14 apartamente me vlerë të përafërt prej **52,796,550.00** leke,
- 12 njësi tregëtare me vlerë të përafërt prej **75,534,401.00** lekë,
- 12 ndërtesa me vlerë të përafërt prej **226,870,733.00** leke,

- 30 toka dhe truaj me vlerë të përafërt prej **259,946,746.4 lekë,**
- 8 biznese me vlerë të përafërt prej **271,812,880 lekë.**

Ndërkohë janë në process saktësimi, vlerësimi apo legalizimi 12 pasuri, vlera e të cilave nuk është përfshirë në tabelë.

Në pasqyrën e mëposhtme jepen pasuritë e mara në administrim me ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikëve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar dhe KPP sipas llojit dhe statusit, konkretisht :

Pasqyra 2

Pasuritë e mara në administrim me ligjin 10192/2009 dhe KPP për vitin 2020								
Nr. rendor	Emertimi	Pasuri e sekuestruara te vleresuara		Pasuri te konfiskuara		Pasuri proces vleresimi, saktësi mi etj.	Totali i pasurive dhe vlera	
		Nr.	Vlera e përafërt	Nr.	Vlera e perafert			
1	Automjete	21	111263585.00				21	111263585.00
2	Apartamente	3	14696900.00	1	6186577.50		4	20883477.50
3	Njesi tregëtare	19	162057674.00				19	162057674.00
4	Ndertesha,bodrum,gara zhe	4	20191990.00				4	20191990.00
5	troje, Troje&ndertesha,Toka bujqesore	9	309423249.00				9	309423249.00
6	Biznese	3	592685853.00			11	14	592685853.00
7	Llogari bankare	7	421132485.11	4	13983257.50		11	435115742.61
	<b>Totali</b>	<b>66</b>	<b>1,631,451,736.11</b>	<b>5</b>	<b>20,169,835.00</b>	<b>11</b>	<b>82</b>	<b>1,651,621,571.1</b>

Sikundër shihet edhe nga pasqyra 2, numrin më të madh të pasurive të sekuestruara e zene :

- 19 njësi tregëtare me vlerë të përafërt prej **162,057,674.00 lekë,**
- 21 automjete me vlerë të përafërt prej **111,263,585.00 lekë,**
- 9 toka dhe truaj me vlerë të përafërt prej **309,423,249.00 lekë.**

Ndërkohë janë në proces saktësimi, vlerësimi apo legalizimi 11 biznese, vlera e të cilave nuk është përfshirë në tabelë.



Pasqyra 3

<b>Pasurite e mara në administrim për vitin 2020</b>								
Nr. rendor	Emertimi	Pasuri te sekuestruara te vleresuara		Pasuri te konfiskuara		Pasuri te sekuestruara në proces vleresimi, saktesimi etj.	Totali I pasurive dhe vlera	
		Nr.	Vlera e përafërt	Nr.	Vlera e perafert		Nr	Te konf.
1	Automjete	83	183,765,355.00				<b>83</b>	183,765,355.0
2	Apartamente	17	67,493,450.00	1	6186577.50	1	<b>19</b>	73,680,027.5
3	Njesi tregëtare	31	237,592,075.00			7	<b>38</b>	237,592,075.0
4	Ndertesë, bodrum, garazhe	16	247,062,723.00			1	<b>17</b>	247,062,723.0
5	troje, Troje&ndertesë, Toka bujqesore	39	569,369,995.40			1	<b>40</b>	569,369,995.4
6	Biznese	11	864,498,733.00			13	<b>24</b>	864,498,733.0
7	Llogari bankare	10	421,162,618.90	4	13,983,257.50		<b>14</b>	43,545,876.40
<b>Totali per vitin 2020</b>		<b>207</b>	<b>2,590,944,950.30</b>	<b>5</b>	<b>20,169,835.00</b>	<b>23</b>	<b>235</b>	<b>2,611,114,785.30</b>
<b>Totali per vitin 2019</b>		<b>41</b>	<b>216,326,319.00</b>	<b>5</b>	<b>106,981,794.00</b>		<b>46</b>	<b>323,308,113.00</b>

Sikundër shihet edhe nga pasqyra 3, pasuritë e sekuestruara në vitin 2020 janë 230 me një vlerë të përafërt prej **2,590,944,950.30 lekë**, kundrejt 41 pasurive te sekuestruara në vitin 2019 me një vlerë prej **216,326,319.00 lekë**. Kjo për faktin që gjatë këtij viti është implementuar akti normative OFL me të cilin janë sekuestruar 153 pasuri nga 230 pasuri që janë sekuestruar këtë vit. Pra rreth 67 % të pasurive të sekuestruara me një vlerë prej 959,493,214.19 lekë e zene këto pasuri. Ndërkohë që janë konfiskuar 4 llogari bankare dhe një apartament me vlerë prej rreth 20169835.00 lekë.

#### Pasqyra 4. Pasuritë e revokuara në vitin 2020.

Nr.	Emertimi	Subjekti	Njesia	Sasi	Nr dhe data e vendimit	Data e marjes ne dorzim	Vlera e perafert, në lekë
1	Audi A8 blinduar AA 001KF	I.HOXHA	cope	1	nr.32, dt.26.03.2020	27.04.2020	2,250,000.00
2	karburant Alt-oil, Pjeze shijak	A.Hajri	cope	1	Nr 7, dt.27.02.2020	13.05.2020	PROC.VLERE
3	Njesi me sip.100 m2, Tirane N.Dautaj	N.Dautaj	m2	100	Nr.220.dt.10.03.20	21.12.20	22,000,000.00

4	Njësi me sip. 60 m2, Tirane N.Dautaj	N.Dautaj	m2	60	Nr.220.dt.10.03.20	21.12.20	4,017,600.00
5	Shoqëria "Servete Dautaj" Bar-kafe , NIPT L62402043D.Tirane	S. Dautaj			Nr.220.dt.10.03.20	21.12.20	2,000,000.00
6	MB Modeli: ML 350 CDI 4MATIC, Ngjyra: gri e erret AA434MN	N.Dautaj	cope	1	Nr.220.dt.10.03.20	21.12.20	1,500,000.00
7	Autobus Scania AA613KM	E.Canka	cope	1	Nr.101 dt. 10.07.20	24.12.20	2,500,000
8	FORD C - MAX AA 960 PC	F.GJURA	cope	1	NR.14, DT11.03.2020	2.04.2020	344400.00
							<b>32,112,000.00</b>

5- Efektiviteti i përdorimit të pasurive lidhur me dhënien me qira apo investimin e llogarive bankare.

**5.1** Në Tabelen 5. bashkalidhur raportit jepen objektet e dhëna me qira sipas muajve, pasurive dhe subjekteve që i kanë marrë me qira pasuritë. Sikundër shihet edhe nga Tabela 5, totali i të ardhurave nga qiratë është **15,242,246** lekë

*Të gjitha pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara, janë publikuar për dhënie me qira, por kërkesat për marrje me qera kanë qënë shumë të pakta dhe për disa pasuri, nuk ka fare shprehje interesi. Gjatë vitit 2020, shumë qiramarrës për shkak të covid-19, kanë kërkuar prishjen e kontratave të qerave duke e bërë të veshitë sigurimin e të ardhurave të parashikuar kjo e mbështetur në kontratat e lidhura me parë.*

**5.2** Llogaritë bankare të sekuestruara kanë qënë në formën e llogarive rrjedhëse dhe depozitave, në çdo rast është ndjekur një politikë e qartë e investimit të këtyre pasurive.

6-Të ardhurat dhe shpenzimet.

Në tabelën e mëposhtme jepen të ardhurat sipas burimit të krijimit të tyre.

### 6.1 Tabela e të ardhurave sipas burimit të krijimit

	Emërtimi	Vlera në lekë	Vlera në %
1	Qiraja e objekteve	<b>15,242,246</b>	96.6
2	Të ardhurat nga interesat	524,595	3.32
<b>3</b>	Te ardhura nga shitja e pasurive te	0	0

	sek/konfiskuara		
<b>4</b>	Te ardhura nga kamat vonesa per pasurite e dhena me qera	0	0
<b>5</b>	Te ardhura nga revokimi i pasurive	4,390	0.08
	<b>Të ardhura gjithsej</b>	<b>15,771,221</b>	<b>100%</b>

Sikundër shihet edhe nga tabela, zërin kryesor të të ardhurave e zënë të ardhurat e krijuara nga pasuritë e dhëna me qera në shumën 15,242,246 lekë ose 96.6% të totalit të ardhurave .

Pjesa tjetër e të ardhurave prej 4,390 lekë ose 0.08% të totalit të ardhurave, vjen nga të ardhurat e krijuara nga revokimi i pasurisë. ( në momentin kur revokohet pasuria mbahen shpenzimet e kryera për pasurinë (në rastin tonë transport me karotrec)

Shuma e interesave të llogarive bankare të sekuestruara, por të futura në depozita është 524,595 lekë, shumë e vogël, por kjo vjen edhe si rezultat i uljes së interesit nga bankat e nivelit të dytë që ka arritur në nivelin më të ulët historik.

Gjatë vitit 2020, AAPSK-ja ka dhënë 65 **pasuri të sekuestruara** me qera dhe nga vjelja e qerave arkëtoi **15,242,246 lekë**, ndërsa në vitin 2019, AAPSK-ja ka dhënë me qera **38 pasuri** të sek/konf dhe nga vjelja e qerave ka arkëtuar 7,672,650 **leke, ose +7,569,696 leke më shumë** se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në tabelën e mëposhtme jepen pasuritë e dhëna me qira për vitet 2019 dhe 2020.

Pasuritë e dhëna me qira dhe të ardhurat nga qirate.		
Vitet	Numuri i pasurive të dhëna me qira	Te ardhurat nga qirate
2019	40	7,562,650.00
2020	66	15,372,198.00

Kjo rritje e të ardhurave nga qeratë, është arritur në sajë të menaxhimit më të mirë të pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe nëpërmjet publikimit më të shpeshtë të pasurive për dhënie me qera, në faqen zyrtare të AAPSK-së dhe në gazetën e përditshme si dhe rritjes së numrit të pasurive të sekuestruara.

Në tabelën e mëposhtme jepen shpenzimet analitike sipas llojit të kryerjes së tyre. Shpenzimet janë ndarë sipas llojit dhe ndarja e tyre është bërë në lidhje me natyrën e shpenzimit në përputhje me miradministrimin e pronës.

6.2 Tabela e shpenzimeve analitike.

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë	Vlera në %
1	Shërbimi i rojes se objekteve te sek/konf.	17,818,149	46.8
2	Sigurim i domosdoshëm	395,385	1.03
3	Naftë	766,381	2.01
4	Dieta	1,899,480	5
5	Kancelari	195,271	0.51
6	Shpenzime mirëmbajtje	51,906	0.13
7	Pagese qeraje per magazine	3,168,000	8.32
8	Ujë + energji	0	0
9	Taksa vendore	243,051.60	0.63
10	Tatimi ne burim për pronat e dhëna me qira dhe tatimi per shperblim te anetareve te komitetit nderinstitucional per masat e krimit te organizuar.	433,125	1.13
11	Pagat + Sigurime shoqerore	13,060,272	34.4
12	Kthim garanci kontrate	0	0
13	Komisione bankare	29,550	0.07
14	Shpenzime për vlerësim pasurie	0	0
	<b>Shuma e shpenzimeve</b>	38,059,953	100%

Nga tabela shihet qartë se zërin kryesor të shpenzimeve, e zënë shpenzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në shumën prej 17,818,149 leke ose 46.8% të totalit të shpenzimeve.

Mbështetur në VKM nr. 324, datë 02.10.2020, kapitulli i II-të, “Shpënzimet e administrimit te pasurive” pika 2.2 “Shpënzimet për ruajtjen fizike apo digjitale”, AAPSK-ja ka marrë masat për ruajtjen fizike të objekteve të sekuestruara dhe konfiskuara të marra në administrim. AAPSK-ja ka qenë e detyruar të ruajë fizikisht disa pasuri të sekuestruara/konfiskuara, të cilat për shumë arsye, nuk mund të jepen me qera në mënyrë që të krijojnë të ardhura, përkundrazi ato vetëm rrisin shpenzimet e ruajtjes së objekteve.

Në këtë kuadër AAPSK-ja ka shpallur për dhënien me qera të gjitha pasuritë e paluajtëshme të sekuestruara/konfiskuara, por jo për të gjitha objektet ka patur interes. Kjo lidhet me faktin e vendodhjes së pronës, problemit në lidhje me pronarin e pronës (Probleme me Ligjin) me mundësinë e kufizuar për të bërë investime në pasurinë e marrë me qira nga qiramarrësi, me afatin e përdorimit të pronës me qera, (Kontratat e qeradhënies, nuk mund të jenë më shumë se një vit kalendarik, më të drejtë përsëritje) apo prona të sekuestruara me vendim Gjykate me

pronësi të pjesëshme. Për këtë arsye AAPSK-ja detyrohet të vendosë në objekte shërbimin e ruajtjes së objekteve deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

Zërin e dytë kryesor të shpenzimeve e zënë pagat + sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në shumën prej 13,060,272 lekë ose me 34.4% të totalit të shpenzimeve .

Gjatë vitit 2020, nuk janë kryer disa shpenzime si : shpenzime për pagesë ekspertit për vlerësim pasurie/ekspert kontabël, ujë + energji, etj. Kjo ka ardhur për arsye se gjatë vitit 2020 nuk kemi patur ndonjë vendim gjykatë të formës së prerë për konfiskim pasurie dhe si rrjedhim nuk ka qënë e domosdoshme nevoja për vlerësim pasurie të eksperteve.

Gjatë kësaj periudhe është bërë dhe sigurimi i pasurive të paluajtëshme pranë kompanive të sigurimeve, konform ligjeve dhe vendimeve në fuqi, në shumën totale 395,385 lekë ose në 1.03% të totalit të shpenzimeve .

Gjatë vitit 2020, është paguar në kohë tatimi në burim(15% ) i krijuar mbi të ardhurat nga pasuritë e dhëna me qera në shumën 433,125 lekë ose 1.13% e totalit të shpenzimeve .

Për vazhdimin e aktivitetit të AAPSK-së shërben edhe një magazinë me qera, ku janë të depozituara një pjesë e pasurive të luajtëshme të sekuestruara, kryesisht automjete në kuader të veprimtarisë së OFL-së. Aktualisht magazina është e mbushur plot dhe nuk ka vende të lira për automjete të tjera. Shuma e pagesës për qiranë e vjetor është 3,168,000 lekë, ose 8.32% të totalit të shpenzimeve.

## 7-Mbi realizimin e Prokurimeve Publike për vitin 2020

Mbështetur në nenin 29, pika 5, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 3, Kreu IV të Vëndimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë. 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” udhëzimin nr 01. datë 05.01.2018, AAPSK-ja ka dërguar pranë institucionit përgjegjës “Regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike” për vitin 2020 sipas fondeve të planifikuara dhe ka hedhur në sistemin elektronik të APP-se rregjistrin.

Mbështetur në ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për vitin 2020, AAPSK-ja ka kryer procedurat e Prokurimit Publik, kryesisht me procedurë me “Blerje të vogla”, nga njësia e Prokurimit e ngritur me Urdhër të Titullarit të Institucionit, nr. 52, datë 13.01.2020.

Për vitin 2020, janë lëshuar nga Kryeadministratori i AAPSK-së gjithsej 7(shtatë) Urdhëra Prokurimi me “Blerje të Vogla” si më poshtë vijon:

- a) Urdhër Prokurimi nr. 99 datë 23.01.2020, “Blerje Sigurim i domosdoshem” (ZTE)”, me fond limit 100,000 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 100,000 lekë pa tvsh.

- b) Urdhër Prokurimi nr.160, datë 10.02.2020 ,“Blerje Gazoil”, me fond limit 800,000 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 722,925 lekë pa tvsh, ose 867,510 leke me Tvsh.
- c) Urdhër Prokurimi nr. 125, datë 03.02.2020, “Blerje shërbim transport me karrotrec”, me fond limit 201,500 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 172,000 lekë pa tvsh,ose 206, 400 lekë me Tvsh.
- d) Urdhër Prokurimi nr. 781 datë 03.06.2020,“Blerje Sigurim i domosdoshem” (ZTE)”, me fond limit 295,444 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 295,300 lekë pa tvsh.
- e) Urdhër Prokurimi nr. 916 datë 24.06.2020,“Blerje Kancelari”, me fond limit 396,620 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 179,000 lekë pa tvsh, ose 214,800 lekë me tvsh
- f) Urdhër Prokurimi nr. 927 datë 24.06.2020,“Blerje Tonëra për printera dhe fotokopje”, me fond limit 198,311 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 128,800 lekë pa tvsh, ose 124,560 lekë me tvsh
- g) Urdhër Prokurimi nr. 1855 datë 05.11.2020,“Blerje shërbimi riparim”, me fond limit 384,500 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 359,400 lekë me tvsh.

Dy Urdhëra Prokurimi janë anuluar si procedura, si rezultat i tërheqjeve nga procedura të operatorëve ekonomik dhe ofertave të paraqitura mbi fondin limit.

Mbështetur në Rregjistrin e parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2020, AAPSK-ja ka kryer edhe 4 (kater) procedura prokurimi me blerje të vogla nën vlerën 100,000 lekë pa Tvsh.

- 1) “Blerje siguracion autoveture (TPL)”, me fond limit 19,820 lekë pa tvsh dhe realizuar 19,820 lekë pa tvsh.
- 2) “Blerje materiale pastrimi për zyrat” me fond limit 100,000 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 99,070 lekë pa tvsh. procedurë prokurimi me blerje të vogla nën vlerën 100,000 lekë pa Tvsh
- 3) “Blerje shërbimi të dizinfektimit të ambjenteve dhe zyrave të AAPSK-së”, me fond limit 300,000 lekë pa tvsh dhe realizuar 299,933 lekë pa tvsh, dhe 359,920 leke me Tvsh, procedurë e realizuar me formular urgjence procedurë e paraparë në legjislacionin në fuqi.
- 4) “Blerje shërbimi të dizinfektimit të ambjenteve dhe zyrave të AAPSK-së”, me vlere 97,500 lekë pa tvsh dhe realizuar 117,000 lekë me tvsh, procedurë e realizuar me formular urgjence procedurë e paraparë në legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2020, AAPSK-ja ka zhvilluar edhe dy procedura tenderash të hapura si më poshtë vijon:

- “Blerje shërbimi të ruajtjes fizike me roje te pasurive te sek/konf. të AAPSK-së”.  
Procedura “Negocim pa shpallje paraprake te kontrates” me fond limit 2,632,433 lekë pa Tvsh dhe 3,158,918 leke me Tvsh, Tenderi eshte realizuar dhe kontrata eshte e mbyllur ne daten 14.07.2020 ne shumen 3,158,918 leke me Tvsh

- “Blerje shërbimi të ruajtjes fizike me roje te pasurive te sek/konf. të AAPSK-së”.  
Procedura e hapur “Mareveshje Kuader” me nr. Prokurimi 576, date 24.04.2020, fond limit 31,589,193.79 lekë pa Tvsh dhe 37,907,020 leke me Tvsh. Realizimi i kontrates sapo ka filluar dhe është në vazhdim.

Gjatë vitit 2020, AAPSK-ja i ka deleguar fondet Agjencisë së Përqëndruar për të zhvilluar procedurën “Blerjen materiale të nevojshme për mbrojtjen personale” dhe ”Shërbime dezinfektimi” me fond total 494,352 leke pa tvsh ose 593,222.40 me tvsh.

Aktualisht, është realizuar kontrata me operatorin ekonomik fitues për lotin e parë, në shumën 157,500 lekë pa tvsh dhe 189,000 lekë me tvsh dhe operatorin ekonomik fitues për lotin e dytë në shumën 89,300 lekë pa tvsh dhe 107,160 leke me tvsh

Për lotin e tretë, ”Shërbime dezinfektimi”, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, ka kryer procedurat e tenderit dhe ka shpallur fituesin, por nuk i është dërguar AAPSK-së, Autorizimi për lidhje kontate me operatorin ekonomik të shpallur fitues te tenderit ,”Shërbime dezinfektimi”.

Duke qënë se AAPSK-ja nuk ka kontratë të lidhur me ndonjë operator ekonomik për dizinfektimin është detyruar të procedojë me formularin e urgjences, procedurë kjo e paraparë në ligj.

Në vitin 2020 AAPSK-ja, nuk ka të planifikuar në buxhet fond investimesh. Bashkëlidhur roportit, gjendet pasqyra e realizimit të prokurimeve me blerje të vogla për vitin 2020, tabela nr.6.

Në kuadrin e miratimit të strukturës dhe organikes së re, ku parashikohet një shtesë e numrit të punonjësve të AAPSK-së, theksojmë se është e domosdoshme planifikimi në buxhet të investimeve për vitin 2021, që do ti shërbejnë Agjencisë, për “Blerje paisje zyrash, kompjutera, printera” etj.

## 8-Funksionimi administrativ i AAPSK-së.

Gjatë këtij viti, Sektori Administrativ ka vijuar punën për mbarëvajtjen e aktivitetit të përditshëm të Agjencisë, si për sa i përket shërbimeve mbështetëse, ashtu edhe për burimet njerëzore.

Është kryer inventarizimi i aseteve dhe materialeve në përdorim të punonjësve të Agjencisë. Është bere inventarizimi i gjendjes në dy magazinat (atë të Agjencisë dhe magazinën e administratoreve). Janë mbajtur proces verbalet përkatëse ku janë kryer edhe vlerësimet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të dëmtuara të prishura apo jashtë funksionit.

Është realizuar procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimi i inventarit të imët dhe aseteve jashtë funksioni. Janë hartuar pasqyrat financiare dhe është kryer mbyllja e bilancit vjetor të aktivitetit buxhetor të Agjencisë për vitin 2019, si dhe dorëzimi i tij në kohë, pranë degës së Thesarit Tiranë.

Është hartuar Regjistri i parashikimeve të prokurimeve dhe dërguar në APP brenda afatit.

Është vijuar me ndjekjen e procedurave të Prokurimeve Publike të programuara, si dhe është kryer pagesa në kohë e të gjitha detyrimeve. Gjithashtu, janë kryer rakordime të herëpashershme me Degën e Thesarit për sa i përket Urdhër shpenzimeve.

Administratorët e pasurive për gjatë kësaj periudhe janë 10 (persona) persona. Shtimi i një administratori në muajin mars të këtij viti ka ardhur si rezultat i implementimit të ligjit për OFL.

Vlen të theksohet, vendosja e programit të sistemit të informatizimit të të dhënave. Firma fituese e projektit realizues e perzgjedhur nga AKSH-i ka instaluar programin në AAPSK, ka kryer trajnime për administratorët dhe punonjësit e AAPSK-së dhe është në monitorim të procesit, për zgjidhjen e problemeve që janë shfaqur gjatë hedhjes së të dhënave dhe perpunimit të tyre. Ka perfunduar hedhja e të dhënave para instalimit të programit dhe vazhdon hedhja e të dhënave të reja. Po punohet për nxjerjen e treguesve përgjithësues të aktivitetit të AAPSK. Me miratimin e VKM me nr.825,dt.28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”, përcaktohen institucionet që kanë të drejtë në marrjen e informacionit nga rregjistri.

9- Disa elemente themelore të performancës së AAPSK. Administrimi i drejtëpërdrejtë i disa shoqërive të sekuestruara.

Në përputhje me kërkesën themelore të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin 70,dt. 27.4.2017, për miradministrimin e pasurisë dhe detyrave që rrjedhin prej tij, nga ligji i ri nr.34, date 4.07.2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, efikasiteti i punës së AAPSK-se do të performohej në disa elemente thelbësore, sipas një plani masash të përcaktuara qartë e lidhur kjo me ecurinë e procesit të ndryshimeve ligjore.

A- Disa elemente themelore të performancës së AAPSK.

1. **Në bashkëpunim me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe Drejtorive Vendore të Policisë** po punohet në vazhdimësi për evidentimin dhe inventarizimin e provave materiale. Në bazë të urdhrit të brendshëm të nxjerë nga kryeadministratori me nr.959, dt 29.06.2020 është hartuar kalendari për 12 qarqet me personat përgjegjës dhe kordinues të cilët kanë marrë kontaktet dhe po punojnë për këtë qëllim.
2. **Mbi vendimet e gjykatave të ardhura dhe realizimet e marrjes së pasurive.** *Nuk ka asnjë rast të vetëm që administratori i pasurisë të mos i jetë përgjigjur OPGJ në kohën dhe vendin e kërkuar, për marrjen në dorëzim të pasurisë.* Edhe kur ka pasur vonesa në marrjen në administrim, kjo ka ardhur për efekt të mos koordinimit të OPGJ me institucione të tjera (pushtet lokal, topograf, polici, subjekt). E rëndësishme të theksojmë se vetëm në muajin



dhjetor janë sekuestruar mbi 200 pasuri me OFL vendimet e të cilave kanë ardhur në muajin janar të vitit 2021.

3. **Komunikimin me prokurorinë, gjyqësorin dhe institucionet e tjera.** Në çdo rast administratori i pasurisë, që në momentin e mbërritjes së vendimit të gjykatës dhe marrjes së pasurisë, ka njoftuar institucionet mbi realizimin e procesit dhe të marrjes në administrim të saj, me ndryshimet që mund të ketë kjo pasuri. Me ndryshimet e reja në ligjin nr. 70, dt 27.04.2017 (dorezimi i pasurive të sekuestruara tek administratoret e AAPSK-se behet nga Oficeret e Policisë Gjyqësore), ky bashkepunim është rritur.
4. **Në rastet e revokimit të pasurive, në asnjë rast nuk jemi penalizuar për mos administrim të mirë të pasurive,** qoftë kjo pasuri e paluajtshme apo llogari bankare. Nuk ka asnjë proces gjyqësor për këtë qëllim, me pasoja financiare.
5. **Për një efikasitet në administrimin e pasurive, janë publikuar të gjitha pasuritë e paluajtshme të mundshme,** për dhënie me qira, apo është kërkuar interesi më i mirë në treg, për llogaritë e depozituara.
6. **Kemi bashkepunuar me Partners Albania dhe Delegacionin e BE për implementimin e projektit C.A.U.S.E.** Pas përfundimit dhe suksesit që pati projekti i parë në pronën e konfiskuar pasticeri “Ke Buono” janë përfunduar dhe dy projekte të tjera “KinFolk Coffe Library” në Durrës dhe “Social Crafting Garage Saranda” në qytetin e Sarandës të cilat u inaguruan dhe kanë filluar aktivitetin, ku u zhvillua dhe konferenca e mbylljes së këtij projekti, si pjesë e projektit C.A.U.S.E implementuar nga Partners Albania për ndryshim e zhvillim në bashkepunim me AAPSK e financuar nga BE me vlerë 350 mijë Euro.

## B-Administrimi i drejtperdrejte i disa shoqërive të sekuestruara.

Nga 24 biznese që ka marrë në administrim AAPSK këtë vit dhe bizneseve të mara në periudhat e mëparshme, një numër i madh i shoqërive dhe bizneseve janë në administrim të drejtperdrejte nga administratorët e AAPSK. Këtu mund të përmendim rreth 11 shoqëritë e subjektit Ylli Ndroqi, disa prej të cilave në aktivitet të plotë, shoqërinë “Santa Quaranta Premium “Resort” , “Rei Plastika”, “Golden Resort”, “AL Gaz”, “Fabriken e Vajit të Ullirit” Tepelene, pularine “Reis 2015” Shkodër, Bar restorant “S. Dautaj “etj.

Në vijim po trajtojmë disa nga shoqëritë në administrim të drejtperdrejte nga AAPSK dhe konkretisht:

### 1-Shoqëria “Rei Plastika”

Bazuar në ligjin 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 03 datë 07.02.2020, të Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, është vendosur sekuestrimi i shoqërisë “Rei Plastika “sh.p.k.



Në datën 11.02.2020 Shoqëria “Rey Plastica” Sh.p.k u mor në administrim nga ana e AAPSK. Referuar Pasqyrave Financiare të vitit 2019 Vlera e Aseteve të shoqërisë është 414,786,590 lekë. Aktualisht kjo shoqëri në organikën e saj ka 25 punonjës.

Aktiviteti i shoqërisë është prodhimi i produkteve plastike të guzhinës një përdorimshe si gota dhe pjata plastike. Shoqëria është e pajisur me Autorizim të Perpunimit Aktiv dhe të gjitha produktet i eksporton në Itali. Prodhimet si gota plastike një përdorimshe dhe pjata plastike një përdorimshe eksportohen në Itali.

Për vitin 2020 janë lidhur dy kontrata me shoqërinë “FILTERTECNIN” për 1450 ton me qender në Bari dhe me shoqërinë “ M&D VOLSE Distribucione SRL” për 1450 ton me qendër Gravina Pulglia ( Bari). Shoqëria punon me tre turne me mesatarisht 22 dite pune në muaj. Si pasojë e pandemisë Covid 19 aktiviteti i shoqërisë u mbyll nga periudha 12 Mars 2020 deri më 05 maj 2020 për arsye se klientet që kjo shoqëri ka, ishin shtetas Italian. Për periudhën 8 muaj Janar-Gusht 2020 të ardhurat e shoqërisë kanë qënë 48,550,793.53 lekë dhe shpenzimet 53,266,061 lekë. Humbja ka erdhur si rezultat i mbylljes së fabrikës për rreth 2 muaj. Aktiviteti përsëri ka filluar dhe është kthyer në normalitet, por kjo shoqëri nuk ka përfituar asnjë ndihmë financiare nga shteti për arsye sepse nuk plotësonte kriteret të gjitha pagesat me furnitorët dhe klientët e shoqërisë nga momenti i marrjes në administrim realizohen nëpërmjet bankës.

Shoqëria ka arritur të gjejë furnitor edhe në shtetin Grek me një cmim më të favorshëm krahasuar me furnitorët ekzistues. Aktualisht jemi në bisedime me drejtorin e përgjithshëm të Burgurt Tiranë për të blerë produktet tek Rey Plastica, për të shërbuar ushqimin të burgosurve. Gjithashtu jemi në bisedime edhe me drejtorët e spitaleve që produktet që prodhon Rey Plastica të arrijmë të furnizojmë edhe spitale.

Të ardhurat që Rey Plastica ka gjeneruar gjatë muajit Tetor, Nëntor dhe Dhjetor janë 29,563,337.0 lekë dhe shpenzimet për këtë periudhë janë 26,424,053.0 lekë. Ky fitim e zbut disi

gjendjen e krijuar në muajt e parë të vitit si rezultat i pandemisë.

## **2-Shoqëria “AL-GAZ 2015”sh.a.**

Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me nr.1522, dt. 20.10.2019, shoqëria “AL-GAZ 2015”sh.a. me qendër në Tiranë i subjektit Lindita dhe Arjan Shanaj u vu ne sekuestro preventive dhe u mor administrim nga AAPSK në dt. !4.01.2020.



Aktiviteti i kësaj shoqërie është është i lidhur me depozitimin dhe tregëtimin e gazit të lengshem brenda dhe jashtë teritorit të vendit, kryesisht në Kosovë, nepërmjet depozitimit të gazit në disa pika të vendit dhe konkretisht:

1-Porto Romano,Durres. 2-Vore,Tiranë.3-Drizaj, Fier dhe 4-Neviçsht, Korçë me një sipërfaqe të përgjithshme trualli prej 6496 m<sup>2</sup>. Vlera e investimit është 572,145,853.0 lekë.

Administrimi i kësaj shoqërie 2020 e ne vijim është realizuar nëprmet kontratës së lidhur nga administratori i AAPSK me shoqërinë “FAM GAZ LLC” Kosovë, kundrejt vlerës së qirasë mujore prej 15, 000 eurosh në muaj.

Nga situata e krijuar prej pandemisë, mbështetur edhe në Aktin Normativ të KM nr.12, dt.2.04.2020 është riformatuar vlera e qirasë për periudhën deri në fund të vitit 2020 në shumë e

rreth 135.000 euro pasi janë zbritur shpenzimet e administrimit.

### 3-Shoqëri Tregëtare “ RENS 2015”sh.p.k

Shoqëria“ RENS 2015” sh.p.k.me ortak të vetëm shtetasin Astrit Beqiri, me vendndodhje Bërdicë e Sipërme,Shkodër, ushtron aktivitetin në fushën e pularisë me një sipërfaqe të shtrirjes së objektit prej 1000 m<sup>2</sup> dhe është sekuestruar me Vendimin penal të Gjykatës së Shkalles së Parë të Krimeve të Renda nr. 418, dt 17.10.2019. datë 11.11.2019.



Administrimi i drejtpërdrejtë për periudhën nga marrja në administrim datë 11.11.2019 dhe në vijim ka problematikat e saj të menaxhimit dhe konkretisht :

- a. Detyrimet e mbartura ndaj të tremeve para marrjes në administrim janë rreth 8,500,000.0 lekë.
- b. Numri i pulave është rreth 31,000copë dhe janë ato ekzistuese me moshë mbi 3 vjeçe ( joproductive).
- c. Stabilimentet e mbarështrimit të pulave janë për një periudhë 5-vjeçare aktiviteti, me një vlerë investimi prej 18,771,749 lekë e cila ka sjellë amortizimin e tyre dhe e bën të domozdoshme ndërhyrjen në riparime kapitale.
- d. Largësinë e vendodhjes së objektit të pularisë
- e. Stafit prej 11 punonjësish është ai ekzistues, që nga marrja në administrim.
- f. Kontraktimi i punonjësve të tjerë është i vështirë, nisur nga:
  - Statusi i pasurisë, i sekuestruar (në administrim të shtetit)
  - Informacionet si nga mediat ashtu dhe nga banorët e zones ku ndodhet shoqëria mbi



emrin e personit që e ka pasur.

- Largësia e objektit nga rruga kryesore.

Jemi në përpilimin e procedurave mbi dhënien me qira si mënyra më efektive e menaxhimit, mbasi detyrimet ndaj të tretëve janë rritur me rreth 250,000 lekë dhe duke pasur parasysh që për administrimin e fermës kërkohen fonde dhe sigurimi i tyre nga ana jonë është i pamundur. Me fillimin nga puna e Komitetit Ndërmintor për Masat Kundër Krimit të Organizuar, do të propozohet shitja e shoqërisë

#### **4-Bar restorant “S. Dautaj”sh.p.k.**

Në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër Pasurisë”, i ndryshuar me ligjin nr.70/2017, si dhe në zbatim të vendimit nr. (396) 220, dt. 10.03.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Kukës është vendosur masa e sekuestros mbi ndër të tjera për Bar-kafe “piano-bar”, në rrugën “Petronini Luarasi”, në afërsi të “Shkollës së Baletit”, Tiranë, në emër të Servete Dautaj, me NIPT: L62402043D.



Pas mbylljes si pasojë e masave parandaluese, shoqëria e rinisi aktivitetin në datën 18 Maj, dhe Përgjatë të gjithë periudhës Maj; Qershor; Korrik; Gusht dhe Shtator, zhvillimi i një aktiviteti normal ekonomik ka qënë i vështirë. Në zbatim të Aktit Normativ nr.2 datë 11.03.2020, “për disa htesa dhe ndryshime” në ligjin 15/2016 “për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe ëmundjeve infektive”, numri i tavolinave që ofrojnë shërbim është i reduktuar. Në respektim të lispozitave të Aktit Normativ të sipërcituar, nuk lejohet që në ambjentet e brendshme të përdoret uji i kondicionuar dhe si pasojë e orjentimit nga Jug-Lindja e ambjentit të Bar-Kafes, përgjatë

shpërndarjes së madhe të ditës, mbizotërojnë temperaturat e larta në ambientin e tij, faktor që ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në aktivitetin e Shoqërisë. Por gjithësesi, përgjatë periudhës: 18 Maj-Shtator të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit kanë qënë 2,652,921.49 Lekë ndërsa shpenzimet 2,311,067.93 Lekë. Fitimi për këtë periudhë llogaritet në 341,853.56 Lekë. **Shoqëri u revokua në muajin dhjetor të 2020 , pa patur asnjë problem gjatë dorzimit tek subjekti.**

### **3-Shqëria “Santa Quaranta Premium Resort”**

Në zbatim të ligjit 10192/2009 dhe vendimit nr 28, 21.11.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, u mor në administrim të drejtpërdrejtë subjekti turistik “Santa Quaranta Premium Resort”.

Për dy vitet e para të administrimit nga ana e AAPSK ka patur respektivisht, një fitim neto prej 70,735,357.0 për vitin 2018 dhe për vitin 2019 një fitim neto prej 46,707,430.0 lekë.

Gjate vitit 2020 aktiviteti ne subjektin turistik “Santa Quaranta Premium Resort” eshte zhvilluar aktiviteti duke shfrytëzuar te gjitha pikat e shitjes te pajisura me pajisjet fiskale perkatese nen regjimin tatimor 20% dhe 6% per hotelerine.

Te ardhurat totale gjate vitit 2020 kane qene **85,711,797** leke pa tvsh te ndara perkatesisht:

- Te ardhura nga hoteleria 19960752 leke pa tvsh
- Te ardhura nga shitja e produkteve ne bar, restorant, shezllonge etj. 65751045 leke pa tvsh

Per kete periudhe jane paguar paga dhe sigurime ne shumen **30,530,930** leke perkatesisht: page 26,452,349 leke dhe sigurime shoqerore dhe shendetesore 4,078,581 leke. Numri mesatar i te punesuarëve per vitin 2020 ishte 45.

Gjate vitit 2020 blerjet neto per shpenzimet korente (blerjet gjate muajit minus kthimet pas te mallrave ne fund te sezonit te blera muajt me pare) kane qene ne shumen 44,745,185 leke pa tvsh, te shpjegura nga tabela e meposhteme sipas grupeve perkatese. Tabela nr. 1, tregon me mire shperndarjen e shpenzimeve sipas zerave. Gjithashtu gjate vitit 2020 kemi dhe blerje per Aktive te Qendrushme ne vleren 8,856,798 leke pa tvsh. Gjate vitit 2020 jane paguar 12 keste mujore te tatimit fitimit per periudhen Janar-Dhjetor 2020, ne vleren 11,337,581 leke.

Gjate vitit 2020 ka patur nje numer te larte anulimes per arsye kryesisht te gjendjes se pandemise.



Emërtimi		JANAR -DHJETOR 2020
Shitjet		
705	Shitje mallrash (Bar/Restorant)	65,751,045
TE ARDHURA TE TJERA		
708	Të ardhura nga shitje te tjera (Hoteleri)	19,960,752
<b>Totali I te ardhurave</b>		<b>85,711,797</b>
Materialet e konsumuara		
601 1	Blerje materiale të para (ushqimore, pije, etj.)	26,064,485
601 2	Blerje materiale të tjera (elektrike dhe hidraulike)	766,568
601 3	Blerje materiale ndihmese (detergjente dhe materiale pastrimi)	2,553,818
602	Blerje objekte inventari (aq)	
	Blerje Objekte inventari (inventar I imet)	652,712
604	Gaz i lengshem/nafte gjeneratori	1,025,622
608	Energji elektrike	3,476,235
605	Blerje Mallra	2,004,154
Shuma materiale te konsumuara		<b>36,543,594</b>

Paga e personelit		
641	Pagat dhe shpërblimet e personelit	26,452,349
Sigurimet shoqërore e shëndetësore		
644	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	4,078,581
Shuma paga dhe sigurime		<b>30,530,930</b>
<b>Shpenzime te tjera</b>		
611	Trajtime të përgjithshme (shërbime financiare dhe juridike, etj.)	1,084,385
613	Qera apartamente 2 muaj	181,558
615	Mirëmbajtje dhe riparime	2,691,414
616	Sigurime	649,100
627 01	shpenzime transporti per blerjet	103,152
624	Publicitet, reklama, INTERNET, TV	500,337
628 01	Komisione booking	420,476
628	Shpenzime për shërbimet bankare	293,727
632	Takse zenie hapesire publike plazhi	1,906,400
	Leje ISHSH dhe Leje dhe akt teknik per MZSH	83,000
618	Kancelari	288,042
Shuma shpenzime te tjera		<b>8,201,591</b>
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>75,276,115</b>
Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore		10,435,682
<b>Fitimi (Humbja) para tatimit</b>		<b>10,435,682</b>
<b>Shpenzimet e tatimit mbi fitimin</b>		
69	Tatimi mbi fitimin	0
<b>Fitimi periudhes</b>		<b>10,435,682</b>

10- Problemet specifike me të cilat jemi ndeshur dhe do të vazhdojmë të ndeshemi në të ardhmen.

Më poshtë po relatojmë shkurtimisht problemet kryesore me të cilat është ndeshur AAPSK-ja dhe situatën e re të krijuar mbas ndryshimeve të ligjeve 10192/2009 dhe 34/2019, e për më tepër me implementimin e Aktit Normativ nr1,dt.31.01.2020(OFL).

- 1- Mos funksionimi i Gjykatës se Larte te krimeve te renda**, ka sjelle vonesa në trajtimin e shumë çështjeve dhe rrjedhimisht, kane shkaktuar një zvarritje në kohe dhe shpenzime për miradministrimin e tyre.
- 2- Vonesa në marjen në administrim të pasurive nga ana e OPGJ.** Mos dorzimi në kohë nga ana e OPGJ me elementet e plote të specifikuara për pasuritë ka sjelle, që numri i pasurive të



pa mara në dorzim të jetë mjaft i lartë. *Si pasoje e vendimeve të mara nga gjykatat në fund të dhjetorit me aktin normativ janë mbi 200 pasuri të pa mara në dorzim, vendimet e të cilave kanë ardhur në muajin janar të vitit 2021.*

- 3- Për disa pasuri të luajtshme që ju bie vlera në një kohë të shpejtë,** kemi kërkuar nga prokuroria dhe gjykatat vendimin për shitjen e tyre të menjëhershëm. Deri më sot sugjerimet dhe kërkesat tona nuk janë mare në konsideratë. *Me ndryshimet e ndodhura në ligjin 34/2019, ku kjo inisiativë meret nga Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar mendojmë se ky problem do të marrë rrugën e zgjidhjes.*
- 4- Mungesa e një ambjenti të përshtatshëm për magazinimin e pasurive të luajtshme dhe provave materiale.** Në kushtet kur është rritur ndjeshëm aktiviteti i AAPSK me implementimin e Aktit Normativ nr1,dt.31.01.2020(OFL), ndryshimet ligjore dhe rrjedhimisht është shtuar numri i pasurive të mara në administrim del si domosdoshmëri rritje e kapaciteteve për magazinimin e pasurive të luajtshme dhe provave materiale. *E rëndësishme të theksojmë se vetëm numri i automjeteve të sekuestruara për vitin 2020 është 83 copë, që kryesisht qëndrojnë në ambjentet e komisariateve të rretheve dhe FNSH.*
- 5- Riformatimi i strukturës së AAPSK në bazë të urdhrit të Kryeministrit me nr. 14,dt 13.01.2021 me shtimin e personelit dhe krijimin e strukturave të reja,** kërkon ambjente më të mëdha dhe investime për realizimin e misionit të tij. *Kjo në veçanti me krijimin e sektorit të shitjes që kërkon kushte specifike për realizimin e ankandeve të shitjes së pasurive të luajtshme dhe provave materiale.*

11- Prioritetet dhe angazhimet institucionale të AAPSK-së për përmirësimin e punës në të ardhmen.

Në vitin në vazhdim AAPSK ka përcaktuar prioritetet që kërkojnë zgjidhje dhe angazhimin e plotë të saj në përmirësimin e punës.

**1- Ndërtimi i sistemit të të dhënave dhe implementimi i tij nga AAPSK-së,** na jep një mundësi shumë të mirë në informatizimin e të dhënave dhe ndjekjen në çdo hap, te ecurisë së marjes në administrim dhe miradministrimin e pasurive. Ky sistem te dhënash na mundëson një koordinim me të mirë midis operacione konkrete që kryen, kohën në të cilën realizohen ato, bashkërendimin e punës me institucionet bashkëpunuese në këtë proces, informacion me të plotë në lidhje me ecurinë e procesit të sekuestrimit apo konfiskimit dhe mbi të gjitha, një efikasitet në punën tonë. Ky sistem do të shërbejë edhe si një lidhje pararendese me institucionet e tjera që marrin pjesë në luftën kundër krimit në përputhje me VKM me nr.825,dt.28.10.2020 “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”, për të krijuar një sistem unik të marjes dhe perpunimit të informacionit në kohe, bashkërendim, unifikim dhe vazhdimësi në të gjitha problemet dhe statistikat në këtë fushë.

**2- Pjesëmarja aktive ne grupet e punes për përafrimin e legjislacionit tone me ate te BE.** AAPSK-ja ka marrë pjesë aktive në 3 grupet e përbashkëta të punës të organizuara dhe bashkërenduara nga MB, MD dhe MPEJ (MONYVAL, Kapitulli 23,24,Strategjine Antikorrupsion) etj. Ne kete konteks nje vend te rendesishem zenë rekomandimet e Moneyval-it.

**3-Përgatitja dhe ndjekja për miratim e akteve nenligjore në zbatim të kërkesave të ligjit 10192/2009 i ndryshuar, 34/2019 i ndryshuar dhe Aktit Normativ nr.1, dt 31.01.2020.** Për këtë qëllim u përgatitën 3 projekt vendime me relacionet përkatëse, 1 urdhër i kryeministrit me relacion përkatës, 2 udhëzime dhe 1 urdhër të Ministrit të Brendshem.

**4-Përmirësimi i marrëdhënieve me institucionet e tjera për sa i përket zbatimit të memorandumeve të ndryshme të bashkëpunimit.**

Trajnimet dhe takimet e përbashkëta me prokurorë, oficerë gjyqësorë dhe punonjës të krimit ekonomik në MPB, janë të domosdoshme të realizohen periodikisht për rritjen e efikasitetit të punës në luftë kundër krimit të organizuar. Vlen të theksohet implementimi i memorandumit të bashkëpunimit midis Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme “për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen në pastrimin e parave, financimin e terorizmit, krimeve financiare dhe sekuestrimin e asetëve kriminale etj”, ku pjesëmarja e AAPSK është pjesë e rendësishme në këtë proces.

**5-Pjesëmarrje dhe aktivitete të zhvilluara nga AAPSK-së.**

Me dt 12-13 shkurt në Tirane u zhvillua mbledhja vjetore e Rrjetit Ndërinstitucional për Menaxhimin e Aseteve në Europën Lindore BAMIN, cili synon të përmirësojë kapacitetet kombëtare për kapjen dhe konfiskimin e pasurive kriminale i cili mbështetet nga OSCE,si dhe u mbajt takimi vjetor ne muajin Nentor gjithashtu dhe u zhvillua dhe nje trajnim 3 ditor ku moren pjese dhe perfaqesues te AAPSK. Në vitin 2021 presidencën e BAMIN-it e merr Shqipëria dhe për këtë jemi të angazhuar që të japim kontributin tonë në përmbushjen e detyrimeve dhe arritjeve të objektivave për të përmirësuar bashkëpunimin dhe efektivitetin tonë ndërinstitucional me gjithë rrjetin BAMIN.

**6- Nga data 23-26 shkurt u zhvillua një vizitë në institucionet homologe ne Berlin,** ku mori pjese AAPSK se bashku me perfaqesues te Ministrise se Brendshme, Ministrise se Drejtesise, SPAK, Prokurorise se Pergjithshme, me objekt rikuperimin e asetëve, produkt të veprimtarisë kriminale.

7-U zhvillua ne muajin tetor trajnim 3 ditor te 9 specialisteve te Agjencise me LIBERA-n Itali ne kuader te marreveshjes se bashkepunimit te AAPSK me ENGIM ne zbatim te projektit Rise Albania.

8-Ne muajin Korrik u nenshkrua nje Memorandum Bashkepunimi mes Institucioneve ligjbatuese nder to dhe Agjencia per te intensifikuar luften ndaj kimit te organizuar dhe per te rritur bashkepunimin.